



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 445/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.06.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Flena RB” shpk, “Oktapus 1 Security” shpk, “Eurogjici Security” shpk, “Snajper Security” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Res 03” shpk, “Dea Security” shpk, “Firdeus Group Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Leksi Security” shpk, “Toni Security” shpk, “Firdeus Security” shpk, “Oktapus” shpk “Arbana” sh.a shpk nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-51690-02-26-2018, me objekt: “Shërbim i sigurimit dhe rojeve në ambientet e DPTTV-së” - Marvveshje kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj”, me fond limit 1,492,266 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 23.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë.

Autoriteti kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë.
Adresa: Rruga “Kavajës”, ish-Uzina Mekanike, Hyrja 203, Tiranë.

Ankimues

“S.S.X” shpk
Adresa: Rruga “5 Maj”, brënda ish-ndërmarrjes kimike, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I***Vlerësimi paraprak*

I I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 01.03.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-51690-02-26-2018, me objekt: “Shërbim i sigurimit dhe rojeve në ambientet e DPTTV-së” - Marvveshje kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj”, me fond limit 1,492,266

lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 23.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë.

II.2. Në datën 23.03.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.3 Në datën 27.02.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. “Vrana Security Group” shpk	Pa dokumentacion	skualifikuar
2. “Pelikani Security Group” shpk	Pa dokumentacion	skualifikuar
3. “Myrto Security” shpk	Pa ofertë	skualifikuar
4. “Safe” shpk	Pa ofertë	skualifikuar
5. “Flena RB” shpk	1,492,255.05 lekë	kualifikuar
6. “Oktapus 1 Security” shpk	1,492,259.28 lekë	kualifikuar
7. “Eurogjici Security” shpk	1,492,265.88 lekë	kualifikuar
8. “Snajper Security” shpk	1,492,266 lekë	kualifikuar
9. “Nazeri 2000” shpk	1,492,266 lekë	kualifikuar
10. “Res 03” shpk	1,492,266 lekë	kualifikuar
11. “Dea Security” shpk	1,492,266 lekë	kualifikuar
12. “Firdeus Security Group” shpk	1,492,266 lekë	kualifikuar
13. “Start 2000” shpk	1,492,266 lekë	kualifikuar
14. “Leksi Security” shpk	1,492,266 lekë	kualifikuar
15. “Toni Security” shpk	1,492,266 lekë	kualifikuar
16. “Firdeus Security” shpk	1,492,266 lekë	kualifikuar
17. “Oktapus” shpk	1,492,266 lekë	kualifikuar
18. “Arbana sh.a” shpk	1,492,266 lekë	kualifikuar
19. “S.S.X” shpk	1,492,266.24 lekë	kualifikuar
20. “Kevenjo” shpk	1,492,266.24 lekë	kualifikuar
21. “Anakonda Security” shpk	1,492,266.24 lekë	kualifikuar
22. “Trezhnjeva” shpk	2,984,532.48 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 27.03.2018, operatori ekonomik “S.S.X” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4.1. Në datën 29.03.2018, operatori ekonomik “S.S.X” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Flena RB” shpk, “Oktapus 1 Security” shpk, “Eurogjici Security” shpk, “Snajper

Security” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Res 03” shpk, “Dea Security” shpk, “Firdeus Group Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Leksi Security” shpk, “Toni Security” shpk, “Firdeus Security” shpk, “Oktapus” shpk “Arbana” sh.a, në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

Në datë 27.03.2018 u njohëm me njoftimin e vlerësimit për tenderin “Shërbim i sigurimit dhe rojeve në ambinetet e DPTTV-së”. Në zbatim të nenit 63 të LPP dhe nenit 78 të RrPP paraqitëm ankesë pranë autoritetit Kontraktor duke kërkuar skualifikimin e operatorëve ekonomik “Flena RB” shpk, “Oktapus 1 Security” shpk, “Eurogjici Security” shpk, “Snajper Security” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Res 03” shpk, “Dea Security” shpk, “Firdeus Group Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Leksi Security” shpk, “Toni Security” shpk, “Firdeus Security” shpk, “Oktapus” shpk “Arbana” sh.a, pasi ofertat e tyre janë nën koston ligjore. Shërbimi i kërkuar nga autoriteti kontraktor është llogaritur të kryhet për një periudhë 12 mujore. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, rezulton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar midis të tjerave:

Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.

Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.

Referuar klasifikimit të ofertave rezulton se këta OE, në përllogaritjet e kryera prej tyre në ofertën ekonomike, nuk kanë përfshirë vlera të pagës minimale mujore për një punonjës shërbimi dhe vlera të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si më poshtë vijon:

Paga bazë minimale mujore = 36000 lekë

Kontributet në masën 16.7 % = 6012 lekë

Totali për një roje në muaj minimalisht = 42.012 lekë

Autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ka kërkuar shprehimisht se të gjithë ofertuesit, në ofertën e tyre ekonomike, duhet të parashikojnë të gjitha detyrimet ligjore për kryerjen e këtij shërbimi; pra më konkretisht ofertuesit duhet të përllogarisin pagën minimale ligjore në vlerën prej 36.000 lekë, si dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16.7 %. Një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret, të gjitha këta O.E, haptazi nuk kanë respektuar dispozitat ligjore për pagën bazë minimale ligjore, si dhe detyrimet ligjore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16.7 %. Është detyrë e operatorëve ekonomik që të garantojnë që oferta e paraqitur nga secili prej tyre të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar

nga AK me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme.

II.4.2. Në datën 04.04.2018, me shkresën nr. 109315/1 prot, operatori ekonomik “S.S.X” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.4.3. Në datën 06.04.2018, pala ankimuese operatori ekonomik “S.S.X” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Me shkresën me nr. 109315/4 prot, datë 16.04.2018, protokolluar me tonën me nr. prot. 707/2, datë 18.04.2018, me objekt “*Dërgim Informacioni*” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “S.S.X” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë “*Flena RB*” shpk, “*Oktapus 1 Security*” shpk, “*Eurogjici Security*” shpk, “*Snajper Security*” shpk, “*Nazeri 2000*” shpk, “*Res 03*” shpk, “*Dea Security*” shpk, “*Firdeus Group Security*” shpk, “*Start 2000*” shpk, “*Leksi Security*” shpk, “*Toni Security*” shpk, “*Firdeus Security*” shpk, “*Oktapus*” shpk “*Arbana*” sh.a, me arsyen se: [...] *Oferat e këtyre operatorëve ekonomikë është nën koston ligjore. Referuar klasifikimit të ofertave rezulton se këta OE, në përllogaritjet e kryera prej tyre në ofertën ekonomike, nuk kanë përfshirë vlera e pagës minimale mujore për një punonjës shërbimi dhe vlera e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore si më poshtë vijon: Paga bazë minimale mujore = 36000 lekë; Kontributet në masën 16.7 % = 6012 lekë; Totali për një roje në muaj minimalisht = 42.012 lekë [...]*”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.1.2. Neni 56 i LPP përcakton shprehimisht se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve ose shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve punë shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.1.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 5, përcaktohet se: “- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.1.4. Referuar nenin 56 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin përfundimtar për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në rast se një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta.

Pra, autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomikë – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalisht të

ulët pas përllogaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentat standart të tenderit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave të një autoriteti kontraktor, në rastin e procedurës së prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të njëjtin detyrim ligjor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pra verifikon ofertat që plotësojnë kriteret kualifikuese, e më pas, nuk rezultojnë të jenë anomalisht të ulëta.

III.1.5. Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 56 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të papërgjegjshme, duke kryer përllogaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalisht të ulëta.

Edhe në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e argumentimit dhe shpjegimit të kësaj oferte nga ana e operatorit ekonomik ankimues duke e dokumentuar, argumentuar me prova shkresore sqarimet për elementin apo elementët e veçantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Në rast se një ofertë ekonomike, autoritetit kontraktor do t'i rezultojë anomalisht e ulët, atëherë, legjislacioni për prokurimin publik ka përcaktuar mënyrën se si ky i fundit mund të mbrohet nga një ofertë e tillë dhe konkretisht duke i kërkuar operatorit ekonomik, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës për:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar sa më sipër, një autoritet kontraktor ashtu siç vepron në çdo procedurë prokurimi, edhe në rastin e procedurës për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të drejtë që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të zbatojë parashikimin ligjor në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në rast se një ofertë rezulton e tillë.

III.1.6. Nga ana tjetër, në rastin e procedurave të prokurimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, nëse një autoritet kontraktor, për shkak edhe të vetë specifikës dhe veçantisë së këtij shërbimi, bazuar në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, ka kërkuar preventive apo analizë kosto, duke përfshirë në të

gjithë elementët ligjorë që përbëjnë një kosto mujore duke detajuar zërat apo elementët e veçantë të kësaj kosto, mbi bazën e të cilave autoriteti kontraktor do të gjykojë ofertën e paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se do të qëndrojë strikt vendimit të autoritetit kontraktor, mbi bazën e të cilit do të gjykojë më pas, si në rastin kur ka kryer vlerësimin e ofertave duke konkluduar mbi ofertën totale, ashtu edhe në rastin kur ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto dhe ka bërë vlerësimin e ofertave duke shqyrtuar secilin zë apo element të veçantë të ofertës.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, argumenton se ky qëndrim i tij bazohet në qëllimet e ligjit të prokurimit publik për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale; sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rast se autoritetet kontraktore do të veprojnë në kundërshtim me sa më sipër, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik do t'i rishikojë administrativisht duke i gjykuar ato si të gabuara.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtëpërdrejtë i shërbimit të kërkuar (në këtë rast shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike), është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo njësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.*

2. Ofertuesit ose kandidatit mund t'i kërkohet të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”.

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, ashtu siç edhe në rastin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike që një element kryesor është paga minimale, e cila në rastet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto apo kur oferta nuk konstatohet të rezultojë anomalisht e ulët, nuk ka pse të jetë objekt kontrolli edhe nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin

dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me pagën minimale të punonjësve në shkallë vendi.

Në rast se ofertat e kualifikuara nuk rezultojnë anomalisht të ulëta, pas përlllogaritjeve përkatëse, apo në rast se rezultojnë të tilla dhe nga autoriteti kontraktor nuk evidentohen shkelje të atij karakteri që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, të tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, si qëllim parësor të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por bindet me provat dhe argumentat e paraqitura nga operatori ekonomik, atëherë, autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në Shtojcën 1 “*Formulari i ofertës*”, , autoriteti kontraktor ndër te tjera ka përcaktuar:

Ishte

Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *(objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1- Çmimi total i ofertës sonë është *[monedha dhe vlera e ofertës]*; pa TVSH;

2- Çmimi total i ofertës sonë është *[monedha dhe vlera e ofertës]*; me TVSH

1	2	3		4	5
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia	Çmimi Njësi /dite	Afati i perlllogaritu ne dite
1.	Sherbimi i ruajtjes se godines se Këshillit të Qarkut Tiranë per 1 vend roje me 2 turne	dite	1		
	Çmimi Neto				

	TVSH (%)
	Çmimi Total

Sqarime:

1. *Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me dy turne.*
2. *Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 2 turne (3.32 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.*

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vendroje me dy turne /dite
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
	Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite		
	Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite		

- *Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".*
- *Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vendroje me dy turne të llogaritet 3.32 (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).*
- *Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomikë ku zërat e koston në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.*

- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar ne dokumentat e tenderit).

Modifikohet në:

Shtojca 1

Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit_____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: (objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1- Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;

2- Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia	Çmimi Njësi /muaj	Afati i perlllogaritur ne muaj
1.	Sherbimi i ruajtjes se ambienteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë per 2 vend roje	muaj	1		
	Çmimi Neto				
	TVSH (%)				
	Çmimi Total				

1. Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne dy vend roje me sherbim ne oraret 07:00 deri në 19:00 dhe 07:00 deri më 17:00.
2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi mujor per 2.96 roje për të 2 vendroje sipas cilesimeve ne piken.3.) në muaj sipas tabelës së

mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos mujore të kryerjes së shërbimit.

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /muaj	Vlera (Lek) 2.96 vendroje /muaj
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë 50% mbi pagën bazë minimale		
3	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
	Vlera totale pa tvsh per 2.96 roje ne muaj		
	Vlera totale me tvsh per 2.96 roje ne muaj		

- *Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".*
- *Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vendroje të llogaritet 2.96 roje gjithsej në ditë për 2 të dyja vendrojet.*
- *Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore,), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.*
- *Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar në dokumentat e tenderit).*

III.1.9. Ndërkohë në shtojcën 7/2, "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 2.3.8 të dokumentave të tenderit, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

"8. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizen e kostos për ofertën e paraqitur. (Shih Shtojca 1 - Sqarime)

III.1.10. Në shtojcën 8 "Specifikimet teknike" të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Të dhëna për shërbimin e kërkuar

Ky shërbim nevojitet të realizohet në dy poste në ditë sipas përcaktimeve të mëposhtëme:

1. Shërbimi me 1 (një) roje, në orarin 07:00 deri në 19:00 (12 orë), nga e Hëna në të Premte në postin: Vendroja në hyrjen e jashtme të territorit të Zyrave të Administratës së DPTTV.
2. Shërbimi me 1 (një) roje, në orarin 07:00 deri në 17:00 (10 orë), nga e Hëna në të Premte në ambientet e Sallës së Pritjes së Subjekteve Taksapagues dhe hyrja për Administratën në DPTTV.

Gjithsej, sipas pikave 1 dhe 2 do të jenë 2.75 roje çdo ditë, nga e Hëna në të Premte me një koeficient 1.0766 në ditë (2.875×1.0766), pra 2.96 roje në ditë

3. Punonjësit e shërbimit duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.
4. Punonjësit e shërbimit duhet të jenë të pajisur me armë dhe uniformë, sipas legjislacionit në fuqi.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj nga momenti i lidhjes së kontratës.

III.1.11. Ndërsa në shtojcën 10 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shërbimi që kërkohet:

Shërbimi që kërkohet: Objekti: “Shërbimi i sigurimit dhe rojeve në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore” Marrveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj (i parashikuar)

Vendndodhja e shërbimit: Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Numri i vëndrojeve

- Nga ora 07:00 deri në 19:00 (dymbëdhjetë orë) nga e Hëna në të Premte në postin: Vendroja në hyrjen e jashtme të territorit të Zyrave të Administratës së DPTTV
- Nga ora 07:00 deri në 17:00 (dhjetë orë), nga e Hëna në të Premte në ambientet e Sallës së Pritjes së Subjekteve Taksapagues dhe hyrja për Administratën në DPTTV.
- Afati i lëvrimet: 12 muaj Kontratat do të jepen nga momenti i lidhjes së Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedurë prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.

III.1.12. Në VKM-në nr. 399, datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” ku shprehimisht përcaktohet: “[...] Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale, orare, të jetë 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) lekë.[...]”

III.1.13. Në Ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 18, gërma “g” është përcaktuar: “Paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 përqind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave”.

III.1.14. Referuar “Kodit të Punës” e më konkretisht:

Neni 81 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Shtesa mbi pagë ”

“Çdo orë pune e kryer nga ora 19.00 deri në 22.00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 20% dhe çdo orë pune e kryer midis intervalit 22.00 dhe 6.00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 50%”,

Neni 82 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Koha javore e punës”

Me kohëzgjatje javore të punës kuptohet koha e punës e kryer nga e hëna në mëngjes ora 0 deri të dielën e ardhshme ora 2400. Në nenin 83 të “Kodit të Punës”, është parashikuar: «Kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë. Ajo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në kontratën kolektive ose në kontratën individuale të punës”.

Neni 85 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Pushimi javor”

- 1) Pushimi javor është jo më pak se 36 orë, prej të cilave 24 orë pa ndërprerje.
- 2) Pushimi javor përfshin ditën e diel.
- 3) Pushimi javor nuk është i pagueshëm.
- 4) Përjashtimet rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 86 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Ditët e festave zyrtare”

- 1) Si rregull ndalohet puna në ditët e festave zyrtare.
- 2) Punëmarrësi gëzon të drejtën e pagës në ditët e festave zyrtare.
Kur dita e festës zyrtare bie në ditët e pushimit javor, pushimi shtyhet ditën e hënë.
- 3) Përjashtimet për të punuar në ditët e festave zyrtare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave ose në kontratën kolektive.

Në nenin 87, po këtui, “puna e kryer ditën e pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompesohet me një shtesë page jo më pak se 25% ose me një pushim të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune, që merret një jave para ose pas kryerjes së saj.”;

Neni 92 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Pushimet vjetore/Kohëzgjatja”

- 1) Kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohen me kontratën kolektive ose me kontratën individuale të punës.

2) Kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo më pak se 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim.

3) Kur punëmarrësi nuk ka kryer një vit pune të plotë, kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohet në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës. Periudhat e paaftësisë së përkohshme në punë, konsiderohen si kohë pune.

III.1.15. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore i të punësuarit, duke filluar nga pjesa e punëdhënësit, është 16,7%, referuar VKM-së nr.77, dt. 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

III.1.16. Në nenin 59, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht:

“Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’ireferohet një ose më shumë alternativavetë renditura si mëposhtë:çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

- çmimet e tregut;ose/dhe

- çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

- çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.”

III.1.17. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ju ka kërkuar të gjithë ofertuesve që të paraqesin ofertën e tyre ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore, si dhe gjatë këtyre përlllogaritjeve të merren parasysh të gjitha parashikimet ligjore në lidhje me pagën bazë minimale ligjore, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë; si dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore.

Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur nga ankimuesi operatori ekonomik “S.S.X” shpk, dokumentacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë “Flena RB” shpk, “Oktapus 1 Security” shpk, “Eurogjici Security” shpk, “Snajper Security” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Res 03” shpk, “Dea Security” shpk, “Firdeus Group Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Leksi Security” shpk, “Toni Security” shpk, “Firdeus Security” shpk, “Oktapus” shpk “Arbana” Sh.a dhe konkretisht elementëve bazë (pagë bazë dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore në masën

16,7%) – elementë këta të cilat janë përcaktuar shprehimisht dhe në DST-; gjykon se operatorët ekonomik të mësipërcituar kanë ofertuar nën koston e lejuar ligjore pasi nuk kanë përlogaritur në përputhje me dispozitat ligjore pagën minimale si dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore. Komisioni sqaron se ka qënë detyrë e operatorëve ekonomikë që të garantojnë që oferta e paraqitur nga secili prej tyre të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar nga AK me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin në fjalë, operatorët ekonomikë të mësipërcituar nuk i kanë përmbushur detyrimet bazë për një ofertë të sukseshme, siç janë llogaritja saktë e pagës bazë minimale ligjore, si dhe të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, në masën dhe vlerat e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimes “S.S.X” shpk në këtë procedurë prokurimi ka ofertuar mbi fond limit.

III.1.18. KPP sqaron se Autoriteti Kontraktor, në përputhje me dispozitat e ligjit për prokurimin publik dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, hartimin dhe miratimin e buxhetit, mirëpërdorimin e fondeve dhe menaxhimin e procedurave të prokurimit publik, përgjegjës direkt për përlogaritjen e fondit limit dhe argumentimin e tij. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nisur nga shërbimi i ruajtjes me 2.96 roje në dy vendroje sic është përshkruar në shtojcën 1 formulari ofertës, në termat e referencës dhe shërbimet e grafikun e ekzekutimit të dokumentave të tenderit si më sipër cituar, vlera limit e kontratës nuk është përlogaritur në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore të sipërpërmëndura, duke sjellë pamjaftueshmërinë për kryerjen e shërbimit të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

III.1.19. Bazuar në nenin 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës; b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj; c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës; ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese”. Në nenin 24, pika 1 “Anulimi i një procedure prokurimi” gërma “dh” të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: dh) Kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji.”

III.1.10. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për shkak të shkeljeve të mësipërme të konstatuara procedura e mësipërme e prokurimit duhet anuluar, kjo pasi nga

përlllogaritjet e kryëra rezultojn se fondi limit është i pa mjaftueshëm për kryerjen e shërbimit. Në zbatim të nenit 64, pika 2 gërma “ç” dhe nenit 24 gërma “dh” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parshikon se “Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji. K.P.P. gjykon se referuar arsyetimit të mësipërm, për shkak të problematikës së shfaqur autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë konstatimet e mësipërme përse i përketë përlllogaritjes së fondit limit në varsi të numrit të punonjësve të parashikuar për kryerjen e këtij shërbimi.

Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimuesit nuk do të merren në shqyrtim

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik “S.S.X” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-51690-02-26-2018, me objekt: “Shërbim i sigurimit dhe rojeve në ambientet e DPTTV-së” - Marvveshje kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj”, me fond limit 1,492,266 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 23.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “S.S.X” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 707 Protokolli; Datë 06.04.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Kryetar
Evis Shurdha